REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:076074
Datë: 13.04.2020
Numri i dokumentit: 00913158

P.nr. 211/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.R, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.370-5/19 e dt.14.02.2019, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur më datë 03.03.2020, në prani të Prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit B.R dhe të përfaqësuesit të palës së dëmtuar –KEDS B.S, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 13.04.2020, përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari B.R, nga i ati R..., e ëma Z..., e gjinisë B..., i lindur me dt.... në Ferizaj ku dhe tani jeton rruga ... pn, me numër personal ...., ka të kryer fakultetin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, i martuar baba i dy fëmijëve, me profesion mësimdhënës, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale dhe ndaj tij nuk udhëheqet ndonjë procedurë tjetër penale.

2019:076075

Ë SH T Ë F A J T O R

Sepse prej datës së pa vërtetuar e deri me dt. 26.11.2018 në lokalin e tij "C,C" , në rrugën ... në Ferizaj,në njehsorin elektrik me nr. ..., punëtoret e autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të shërbimit komunal për vete, është hasur duke keqpërdorur energjinë elektrike, ashtu që përmes një kablle 1x10 mm,është lidhur në "Zbara" ne (3) palëshe jashtë pikës matëse, ka shpenzuar energjin elektrike pa e regjistruar në njësorin elektrik, me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in, në shumë prej 1 826.45 € .

me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 4,7,8,17,21,38,40,43,69,70 dhe nenit 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe në bazë të neneve 365,453,463, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarin e:

GJ Y K O N

Me dënim me gjobë, në shumë prej 200 /dy qind/ €uro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve,nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €uro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

I pandehuri konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së, obligohet që të dëmtuarës KEDS-Distrikti Ferizaj, të ia kompensoj dëmin e shkaktuar të mbetur në shumë prej 1126.45 €, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2019:076075

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë €uro/ , në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Poashtu obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 €uro /tridhjetë euro/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Historiku i Procedurës

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP.II.nr.370-5/19, e dt.14.02.2019, ka ngarkuar të akuzuarin për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 320 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i akuzuari gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt.03.03.2020 në të cilin shqyrtim gjyqësor ishin të pranishëm Prokurori i shtetit Avdullah Abedini, i akuzuari B.R, përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS-B.S dhe dëshmitarët SH.S.1, D.K dhe SH.S.2 .

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Në shqyrtimin gjyqësor të dt.03.03.2020 , gjykata ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenin 323 par. 2 të KPPRK-së, pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata dhe ka deklaruar se heqi dorë nga leximi i aktakuzës pasi që në shqyrtim fillestar kam pranur në kopje të saj dhe e njejta më është lexuar nga prokurori i

2019:076075

shtetit,gjyqtari mëtej në kuptim të nenit nenit 325 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar , në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza e prokurorisë sipas të gjitha pikave të saj .

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini në fjalën hyrse të tij ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B.R, i akuzuar për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, pasi që një pranim të tillë i pandehuri e bëri vullnetarisht dhe ky pranim mbështet në provat dhe faktet që i përmban aktakuza i propozoj gjykatës që të bëj pranimin e fajësisë për të pandehurin.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar –KEDS, B.S në fjalën hyrëse ka deklaruar: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë dhe e përkrahi mendimin e prokurorit të shtetit dhe i bashkangjitem ndjekjes penale dhe paraqes kërkesë pasurore- juridike.

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësin në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar në kuptim të nenit 326 paragrafi 1 të KPPRK-së,ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 paragrafi 1 të KPPRK-së, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit si dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës siç janë: procesverbali numër 0948035 i dt.26.11.2018,kartela e konsumatorit – të pandehurit, fatura mbi dëmin e shkaktuar nga ana e të pandehurit me nr.DFEHP ... i dt. 27.11.2018, fotografitë e vendit të ngjarjes.

Fjala përfundimtare e palëve

Pasi që gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësis nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, konform nenit 326 paragrafi 4 të KPPRK-së,shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve .

2019:076075

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini ne fjalën perfundimtare deklaroi: në kuptim të nenit 3 par. 2 të KPRK-së, bëj rikualifikim ligjor të veprës penale nga vepra penale vjedhja e shërbimeve komunale neni 320 të KPRK-së në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, pasi që parashihet dënimi më i favorshëm për këtë vepër penale.

Pas pranimit të fajsësisë nga i pandehuri për veprën penale si dhe leximit të provave materiale si: procesverbali numër 0948035 i dt.26.11.2018, kartela e konsumatorit – të pandehurit, fatura mbi dëmin e shkaktuar nga ana e të pandehurit me nr.DFEHP .... dt. 27.11.2018, fotografitë e vendit të ngjarjes mbetem në tërësi pran kësaj aktakuze dhe pasi që i akuzuri pranoj fajsin i propozoj gjykatës që të akuzuari ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS-B.S në fjalën përfundimtare ka deklaruar se : e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit i bashkangjitemi ndjekjes penale dhe poashtu paraqesim kërkesë pasurore-juridike, konsiderojm se janë paraqitur mjaftueshëm prova materiale gjykatës që të pandehurin ta gjej dhe ta shpall fajtor , pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë dhe në emër të dëmit të shkaktuar për këtë vepër penale ka bërë pagesën e shumës prej 700 €, bëjmë precizimin e dëmit të shkaktuar ku tani vlera e dëmit të shkaktuar të pa paguar është 1126.45 € .

I akuzuari B.R në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: unë e siq theksova më lartë e pranoj fajësin për veprën penale që më ngarkon akuza, është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe jam munduar ta paguaj dëmin që i kam shkaktuar palës së dëmtuar KEDS , ku para disa muajve kam bërë pagesa dhe kohë pas kohe kam arritur që të paguaj shumën e përgjithshme prej 700 €, dhe në të ardhmen do të mundohem që sa më shpejtë që të është e mundur ta paguaj edhe pjesën tjetër në emër të dëmit që më ka mbetur dhe po premtoj se në të ardhmen më asnjëherë nuk do të përsëris kësi lloj vepre penale.

Të gjeturat e gjykatës,matja dhe shqiptimi i dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin

2019:076075

është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua denim siq është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimin gjyqësorë i akuzuari ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendimin e sinqert dhe real për veprën penale të kryer, se është hera e parë që i akuzuari bie ndesh me ligjin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso lloj vepre penale, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzurin si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprave penale, rrezikshmëris dhe të autorit të saj dhe do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesat pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi obligimin e të pandehurit për pagesën e dëmit të mbetur palës së dëmtuar është marë në kuptim të nenit 463 par. 2 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.2, pika 2.1 dhe 2.6. lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi**.**

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM,DIVIZIONI PENAL
P.nr. 211/19 , datë 13.04.2020

Zyrtare ligjore **Gjyqtari i vetëm gjykues**

Kimete Bytyqi **Imri Sejda**

2019:076075

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe Gjykatën.

2019:076075